



KPMG Albania Shpk  
Deshmoret e Kombit Blvd  
Twin Towers Building 1, floor 13  
Tirana, Albania

+355 (4) 2274 524  
al-office@kpmg.com  
kpmg.com/al


Pronarit dhe Këshillit Drejtues të  
American Hospital Sh.a

30 mars 2018

Të nderuar Zotërinj,

Ju lutem gjeni bashkëngjitur Raportin e Audituesve të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare të  
Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017.

Me respekt,



Heris Jani,  
*Auditues Ligjor*

**AMERICAN HOSPITAL SHA**  
**PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA**  
**për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**  
**(dhe raporti i audituesve të pavarur mbi to)**

## **Përmbajtja**

### **Faqja**

#### **RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR**

#### **PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA:**

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar	1
Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital	3-4
Pasqyra e konsoliduar e flukseve të mjeteve monetare	5
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara	6 – 28

---



KPMG Albania Shpk  
Blvd "Dëshmorët e Kombit"  
Kullat Binjake Kulla 1, Kati 13  
Tiranë, Shqipëri  
+355(4)2274 524  
al-office@kpmg.com  
kpmg.com/al

## Raporti i Audituesve të Pavarur

Për pronarin dhe Këshillin Drejtues të American Hospital Sh.a.

### *Opinion*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të American Hospital Sh.a. ("Grupi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Grupit më 31 dhjetor 2017, performancën e tij financiare të konsoliduar dhe flukset e parasë të konsoliduara për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### *Baza për Opinionin*

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara*. Ne jemi të pavarur nga Grupi në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA), si dhe me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar", të ndryshuar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK dhe Kodin e IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.



*Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdijë Grupin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

*Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara*

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Grupit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Grupit për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesve në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare të konsoliduara, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Grupi të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.
- Sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit në lidhje me informacionet financiare të entiteteve ose veprimtarive të bizneseve brenda Grupit, për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare të konsoliduara. Ne jemi përgjegjës për drejtimin, mbikëqyrjen dhe kryerjen e auditimit të Grupit. Ne mbetemi të vetmit përgjegjës për opinionin e auditimit.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.



Hens Jani  
Auditues Ligjor

KPMG Albania Shpk  
Blvd "Dëshmorët e Kombit"  
Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 13  
Tiranë, Shqipëri

Tiranë, 30 mars 2018

# American Hospital Sha

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor

Shënim	Në '000 Lek		Në '000 Euro		
	2017	2016	2017	2016	
<b>Aktivët</b>					
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	5	50,902	27,695	383	205
Kërkesa të arkëtueshme	6	204,737	366,826	1,540	2,713
Inventarë	7	326,014	358,278	2,452	2,649
Aktive të tjera	8	93,123	86,112	701	637
Tatim fitimi i parapaguar		49,862	7,878	375	58
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>724,638</b>	<b>846,789</b>	<b>5,451</b>	<b>6,262</b>
Aktive afatgjata të trupëzuara	9	2,591,161	2,550,608	19,490	18,861
Aktive afatgjata të patrupëzuara	10	15,610	16,845	117	125
Aktive tatimore të shtyra	20	24,725	-	186	-
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>2,631,496</b>	<b>2,567,453</b>	<b>19,793</b>	<b>18,986</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>3,356,134</b>	<b>3,414,242</b>	<b>25,244</b>	<b>25,248</b>
<b>Detyrimet</b>					
Të pagueshme ndaj furnitorëve për pajisje	11	229,839	161,425	1,699	1,194
Të pagueshme tregtare	11	492,310	465,206	3,732	3,440
Parapagime	11	131,552	61,444	990	454
Qira financiare	11	-	12,811	-	95
Hua	12	401,475	312,218	3,020	2,309
Detyrime të tjera	13	166,233	93,158	1,250	689
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>1,421,409</b>	<b>1,106,262</b>	<b>10,691</b>	<b>8,181</b>
Të pagueshme ndaj furnitorëve për pajisje	11	467,208	472,621	3,514	3,494
Provizione	13	109,147	93,517	821	691
Qira financiare	11	-	80,122	-	592
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>576,355</b>	<b>646,260</b>	<b>4,335</b>	<b>4,777</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>1,997,764</b>	<b>1,752,522</b>	<b>15,026</b>	<b>12,958</b>
<b>Kapitali</b>					
Kapitali aksionar	14	2,930,952	2,930,952	22,457	22,457
Diferenca konvertimi		27,058	16,851	(386)	(649)
Humbje të mbartura		(1,599,640)	(1,286,083)	(11,853)	(9,518)
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>1,358,370</b>	<b>1,661,720</b>	<b>10,218</b>	<b>12,290</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>3,356,134</b>	<b>3,414,242</b>	<b>25,244</b>	<b>25,248</b>

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të konsoliduara të paraqitura në faqet 6 deri në 28.

Shumat ekuivalente në Euro janë paraqitur vetëm për qëllime informimi (shiko shënimin 2).

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë miratuar nga Këshilli Drejtues më 30 mars 2018 dhe janë nënshkruar në emër të tij nga:

Dr. Klodian Allajbeu  
Drejtor ekzekutiv




## American Hospital Sha

Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

	Shënime	Në Lek '000		Në Euro '000	
		2017	2016	2017	2016
Të ardhura	15	5,241,648	4,568,957	39,073	33,261
Të ardhura të tjera		29,312	19,888	219	145
Kosto e materialeve dhe mallrave	16	(1,636,907)	(1,412,401)	(12,202)	(10,282)
Shpenzime personeli	17	(1,768,835)	(1,460,875)	(13,186)	(10,635)
Amortizimi dhe zhvlerësimi	9,10	(355,765)	(374,845)	(2,652)	(2,729)
Humbje nga zhvlerësimi	6	(20,530)	(17,480)	(153)	(127)
Shpenzime të tjera operative	18	(1,708,533)	(1,258,829)	(12,735)	(9,164)
<b>Rezultati nga veprimtaria operative</b>		<b>(219,610)</b>	<b>64,415</b>	<b>(1,636)</b>	<b>469</b>
Të ardhura financiare		2,734	398	20	3
Shpenzime financiare		(121,406)	(113,021)	(905)	(823)
<b>Shpenzimet neto financiare</b>	19	<b>(118,672)</b>	<b>(112,623)</b>	<b>(885)</b>	<b>(820)</b>
<b>Humbja e vitit, para tatimit</b>		<b>(338,282)</b>	<b>(48,208)</b>	<b>(2,521)</b>	<b>(351)</b>
Tatimi mbi fitimin	20	24,725	(40,436)	186	(294)
<b>Humbja e vitit</b>		<b>(313,557)</b>	<b>(88,644)</b>	<b>(2,335)</b>	<b>(645)</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatim fitimi		10,207	8,680	263	249
<b>Totali i humbjes gjithëpërfshirëse të vitit</b>		<b>(303,350)</b>	<b>(79,964)</b>	<b>(2,072)</b>	<b>(396)</b>

Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të konsoliduara të paraqitura në faqet 6 deri në 28.

Shumat ekuivalente në Euro janë paraqitur vetëm për qëllime informimi (shiko shënimin 2).



## American Hospital Sha

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

<i>Në '000 Lek</i>	<b>Kapitali aksionar</b>	<b>Diferenca konvertimi</b>	<b>Humbje të mbartura</b>	<b>Totali</b>
<b>Teprica më 31 dhjetor 2015</b>	<b>2,930,952</b>	<b>8,171</b>	<b>(1,197,439)</b>	<b>1,741,684</b>
<b>Veprimet me pronarin të regjistruara direkt në kapital</b>	-	-	-	-
<b>Totali i humbjes gjithëpërfshirëse të vitit</b>				
Humbja e vitit	-	-	(88,644)	(88,644)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatim fitimi	-	8,680	-	8,680
<b>Totali i humbjes gjithëpërfshirëse të vitit</b>	<b>-</b>	<b>8,680</b>	<b>(88,644)</b>	<b>(79,964)</b>
<b>Teprica më 31 dhjetor 2016</b>	<b>2,930,952</b>	<b>16,851</b>	<b>(1,286,083)</b>	<b>1,661,720</b>
<b>Veprimet me pronarin të regjistruara direkt në kapital</b>	-	-	-	-
<b>Totali i humbjes gjithëpërfshirëse të vitit</b>				
Humbja e vitit	-	-	(313,557)	(313,557)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatim fitimi	-	10,207	-	10,207
<b>Totali i humbjes gjithëpërfshirëse të vitit</b>	<b>-</b>	<b>10,207</b>	<b>(313,557)</b>	<b>(303,350)</b>
<b>Teprica më 31 dhjetor 2017</b>	<b>2,930,952</b>	<b>27,058</b>	<b>(1,599,640)</b>	<b>1,358,370</b>

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të konsoliduara të paraqitura në faqet 6 deri në 28.

## American Hospital Sha

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

<i>Në Euro '000</i>	<b>Kapitali aksionar</b>	<b>Diferenca konvertimi</b>	<b>Humbje të mbartura</b>	<b>Totali</b>
<b>Teprica më 31 dhjetor 2015</b>	<b>22,457</b>	<b>(898)</b>	<b>(8,873)</b>	<b>12,686</b>
<b>Veprimet me pronarin të regjistruara direkt në kapital</b>	-	-	-	-
<b>Totali i humbjes përmbledhëse të vitit</b>				
Humbja e vitit	-	-	(645)	(645)
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatim fitimi	-	249	-	249
Totali i humbjes përmbledhëse të vitit	-	249	(645)	(396)
<b>Teprica më 31 dhjetor 2016</b>	<b>22,457</b>	<b>(649)</b>	<b>(9,518)</b>	<b>12,290</b>
<b>Veprimet me pronarin të regjistruara direkt në kapital</b>	-	-	-	-
<b>Totali i humbjes përmbledhëse të vitit</b>				
Humbja e vitit	-	-	(2,335)	(2,335)
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatim fitimi	-	263	-	263
Totali i humbjes përmbledhëse të vitit	-	263	(2,335)	(2,072)
<b>Teprica më 31 dhjetor 2017</b>	<b>22,457</b>	<b>(386)</b>	<b>(11,853)</b>	<b>10,218</b>

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të konsoliduara të paraqitura në faqet 6 deri në 28.

Shumat ekuivalente në Euro janë paraqitur vetëm për qëllime informimi (shiko shënimin 2).

# American Hospital Sha

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

Shënime	Në Lek '000		Në Euro '000	
	2017	2016	2017	2016
<b>Flukse monetare nga veprimtari operative</b>				
Humbja e periudhës përpara tatimit	(338,282)	(48,208)	(2,521)	(351)
<i>Rregullime për:</i>				
Zhvlerësim dhe amortizim	9,10	355,765	2,652	2,729
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata		33,693	251	64
Fond zhvlerësimi i kërkesave të arkëtueshme	6	20,530	153	127
Provizione	13	16,210	121	191
Humbje nga zhvlerësimi i inventarit		402	3	63
Shpenzime neto financiare	19	118,672	885	820
		<b>206,990</b>	<b>500,367</b>	<b>1,544</b>
				<b>3,643</b>
<i>Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative:</i>				
Inventarë		31,862	238	(540)
Të arkëtueshme		141,559	1,055	(1,655)
Aktive të tjera		(7,011)	(52)	(364)
Të pagueshme tregtare		27,104	202	1,462
Parapagime		70,108	523	-
Detyrime të tjera		72,495	540	13
Interesi i arkëtuar		2,734	20	2
Tatimi i paguar		(41,984)	(313)	(507)
<b>Mjete monetare neto nga veprimtaritë operative</b>		<b>503,857</b>	<b>3,757</b>	<b>2,054</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë investuese</b>				
Blerje e aktiveve afatgjata të trupëzuara dhe të patrupëzuara		(305,409)	(2,272)	(2,467)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata të trupëzuara dhe të patrupëzuara		1,673	12	18
<b>Mjetet monetare neto përdorur në veprimtaritë investuese</b>		<b>(303,736)</b>	<b>(2,260)</b>	<b>(2,449)</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë financuese</b>				
Interes i paguar	12	(118,986)	(887)	(151)
Shlyerje të të pagueshmeve ndaj furnitorëve të paisjeve	12	(138,351)	(1,039)	(648)
Të ardhurat nga huatë	12	89,257	665	-
Pagesa të detyrimeve nga qiraja financiare	12	(8,834)	(66)	1,217
<b>Mjetet monetare neto nga veprimtaritë financuese</b>		<b>(176,914)</b>	<b>(1,319)</b>	<b>418</b>
<b>Rritja neto e mjeteve monetare</b>		<b>23,207</b>	<b>178</b>	<b>23</b>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit		<b>27,695</b>	<b>205</b>	<b>182</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 dhjetor</b>	<b>5</b>	<b>50,902</b>	<b>383</b>	<b>205</b>

Pasqyra e konsoliduar e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të konsoliduara të paraqitura në faqet 6 deri në 28.

Shumat ekuivalente në Euro janë paraqitur vetëm për qëllime informimi (shiko shënimin 2).

# American Hospital Sha

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara

(Shumat në '000 Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

---

### 1. Informacion i përgjithshëm

American Hospital Sha ("Grupi") është një shoqëri që ushtron veprimtarinë e saj në Tiranë dhe zotërohet plotësisht nga Balkan Alliance Healthcare B.V. e bazuar në Hollandë. Grupi është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë, Nr. 35179, datë 10 mars 2006. Grupi është një filial jo i drejtpërdrejtë i Southeast Europe Equity Fund II, L.P., i cili drejtohet nga the Small Enterprise Assistance Funds ("SEAF") SEE Management LLC si drejtues i investimeve. Asnjë nga pjesëmarrësit në Fondin e mësipërm nuk ka kontroll mbi të, pasi pjesëmarrjet nuk kalojnë 25% të totalit.

Grupi është licencuar më 30 janar 2007 dhe rikonfirmuar më 19 shkurt 2008 për të ushtruar veprimtarinë e tij me spitale dhe qendra mjekësore në Shqipëri, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 238, datë 13 prill 2003, "Mbi licencimin e veprimtarisë private në industrinë e kujdesit për shëndetin". Me çeljen e Qendrës Kombëtare të Licencimit në Shqipëri, si i vetmi autoritet licencues në vend, Grupi është licencuar nga ky autoritet më 29 shtator 2009. Grupi është i përfshirë në shërbimet e kujdesit për shëndetin, përfshirë poliklinikën dhe shërbimet kirurgjikale.

American Hospital Kosova Shpk ("Filiali") filloi veprimtarinë në Prishtinë, Kosovë, dhe u regjistrua si Filial në 28 tetor 2011. Ky Filial ka filluar të ushtrojë veprimtarinë në Kosovë që nga viti 2012 dhe në gusht 2015 u zhvendos në një spital të ri dhe më të madh në Prishtinë.

Gjatë vitit 2015, Grupi ka marrë pjesë me 15% të aksioneve të kapitalit të zakonshëm në Dia-Vita shpk e cila ka fituar Konkensionin e Dializës në 2015, për të mbështetur këtë shërbim në pesë qendra të dializës. Kapitali fillestar i regjistruar i Dia-Vita shpk është 1 milion Lek dhe 15% e kontributit kapital të Grupit është kontribut në ekspertizë profesionale dhe veprimtari. Grupi pret të marrë dividendë në të ardhmen nga Dia-Vita, në proporcion me pjesëmarrjen e tij në pronësi.

Në prill 2016, është hapur një qendër e re, laboratorike. Ndërtesa e re ka rritur gamën e shërbimeve të ofruara ndaj publikut, klinikave private dhe spitaleve të Grupit.

Në janar 2017 është hapur spitali i tretë në Tiranë (me një nisje fillestare në nëntor 2016). Kontrata për ndërtesën e re është firmosur në maj 2016 dhe gjatë shtatë muajve pasues Grupi ka punuar për të kryer riprojektimin dhe përmirësimet e nevojshme.

Në tetor 2017 Grupi hapi poliklinikën e parë në Tiranë, në mënyrë që të zgjerojë përfshirjen e tij në shërbimet e konsulencës ambulatore në kryeqytet.

Pasqyrat e konsoliduara financiare përfshijnë Shoqërinë dhe Filialin e saj në Kosovë (së bashku referuar si "Grupi").

Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 Grupi ushtronte veprimtarinë nga një Zyrë Qëndrore në Tiranë me tre spitale operative në Tiranë dhe një në Prishtinë, një Laborator Qëndror, qendra mjekësore në Fier dhe Durrës dhe një poliklinikë në Tiranë.

#### **Zhvillimet aktuale**

Humbja e akumuluar e Grupit vjen kryesisht si rezultat i humbjeve të akumuluar të viteve të kaluara si dhe investimeve në njesitë e reja të shpjeguara në shënimin 1. Aktivitetet e Grupit në Shqipëri dhe Kosovë gjenerojnë flukse pozitive të parasë. Humbja e Grupit vjen si rezultat i aktivitetit në Kosovë dhe në veçanti, nga investimet në spitalin e ri në Prishtinë, i cili ka filluar aktivitetin në vitin 2015; spitalit të ri në Tiranë i cili rezultoi me shpenzime më të larta fikse dhe variabël se sa pritej; dhe zgjatjes së punimeve të rindërtimit në spitalin e parë në Tiranë, të cilat filluan në shkurt 2017 dhe përfunduan plotësisht në shkurt 2018.

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017, Filiali në Kosovë ka raportuar rritje prej 9% (2016: 96%) në të ardhura krahasuar me vitin paraprak, pas fillimit të shërbimeve të reja, veprimtarisë në mjediset e reja dhe volumit më të lartë të shërbimeve ekzistuese. Edhe pse Filiali aktualisht po operon me humbje, drejtimi pret që të vazhdojë të rritet në vitet e ardhshme dhe të rezultojë me fitim në vazhdimësi.

Drejtimi beson se aftësia e Filialit për të vazhduar në bazë të parimit të vijimësisë nuk është përkeqësuar.

# American Hospital Sha

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara

(Shumat në ‘000 Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

---

### 2. Baza e kontabilitetit

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit janë përparitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”), të cilat janë botuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

#### (a) Baza e matjes

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë përparitur mbi bazën e kostos historike.

#### (b) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë paraqitur në Lek Shqiptar (“Lek”), e cila është edhe monedha funksionale e Grupit. I gjithë informacioni financiar i paraqitur në Lek, është rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, nëse nuk shprehet ndryshe.

Përveçse janë paraqitur në Lek, pasqyrat financiare përmbajnë informacion shtesë në Euro për lehtësinë e përdoruesve të pasqyrave financiare. Informacioni shtesë është përparitur duke konvertuar nga ‘000 Lek në ‘000 Euro si më poshtë:

- pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar është konvertuar me kursin e këmbimit në datën e raportimit;
- pasqyra e konsoliduar e të ardhurave përmbledhëse dhe pasqyra e flukseve të parasë janë konvertuar me kursin mesatar të periudhës; dhe
- pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital është konvertuar me kursin e këmbimit në datën e transaksionit fillestar.

#### (c) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përparitja e pasqyrave financiare të konsoliduara kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Vlerësimet dhe supozimet e përmendura rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Në veçanti, informacioni mbi elementet e rëndësishme të pasigurive në vlerësim dhe gjykimet kritike në zbatimin e SNRF-ve, të cilat kanë efektin më të rëndësishëm në pasqyrat financiare të konsoliduara, janë përshkruar në shënimin 4.

### 3. Politikat kryesore kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme gjatë gjithë periudhave të paraqitura në këto pasqyra financiare të konsoliduara, dhe janë zbatuar në mënyrë konsistente edhe nga njësitë e Grupit.

#### (a) Baza e konsolidimit

##### *Filialet*

Filialet janë njësi të kontrolluara nga Grupi. Kontrolli ekziston kur Grupi ka fuqinë të qeverisë politikën financiare dhe operative të një njësie në mënyrë që të marrë përfitime nga aktivitetet e saj. Pasqyrat financiare të Filialeve janë të përfshira në pasqyrat e konsoliduara nga data kur fillon kontrolli, deri në datën kur ai përfundon. Pasqyrat e konsoliduara financiare janë përparitur duke përdorur politikën kontabël të njëjta për transaksionet e ngjashme dhe ngjarje të tjera në rrethana të ngjashme.

##### *Transaksionet e eliminuara në konsolidim*

Tepricat brenda Grupit, si dhe të ardhurat dhe shpenzimet e papërfituara (përfshijë fitimet ose humbjet nga transaksionet në monedhë të huaj) që lindin nga transaksionet brenda Grupit, eliminohen gjatë përparitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara. Humbjet e përfshijë eliminohen në të njëjtën mënyrë si fitimet e përfshijë, por deri në masën kur nuk ka evidencë për rënie të vlerës.

# American Hospital Sha

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara

(Shumat në '000 Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

---

### 3. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

#### (b) Monedhat e huaja

##### *Transaksionet në monedhë të huaj*

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale të Grupit me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare të regjistruara në monedha të huaja në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare të regjistruara në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë të tregut konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë e tregut. Njesite jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat në monedhe të huaj, përgjithësisht njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

##### *Veprimtaritë e huaja*

Aktivitet dhe detyrimet e veprimtarive të huaja përkthehen në Lek me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Të ardhurat dhe shpenzimet e veprimtarive të huaja përkthehen në Lek me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat nga kursi i këmbimit që lindin nga rivlerësimi i veprimtarive të huaja njihen në të ardhurat e tjera përmbledhëse dhe akumulohen në rezervën e rivlerësimit.

#### (c) Instrumentet financiare

##### *Instrumentet financiare jo-derivative*

Aktivitet financiare jo-derivative të Grupit përbëhen nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentet me to, huatë, overdraftet, detyrime të tjera, dhe detyrime tregtare dhe të tjera.

Grupi fillimisht njihet llogaritë e arkëtueshme tregtare e të tjera në datën që ndodhin. Të gjitha aktivitet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, datë në të cilën Grupi bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Grupi çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose kur transferon të drejtat e marrjes së flukseve monetare kontraktuale mbi aktivin financiar nëpërmjet një transaksioni ku transferohen në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e zotërimit të aktivitet financiar, ose kur as nuk transferohen dhe as nuk mbahen rreziqet dhe përfitimet e zotërimit të aktivitet financiar dhe nuk ka kontroll mbi aktivin financiar. Çdo interes në aktivitet financiare të transferuara që është krijuar apo mbajtur nga Grupi, njihet si një aktiv apo detyrim më vete. Grupi çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, anuluar apo kanë skaduar.

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe paraqiten për shumën neto në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë dhe vetëm atëherë kur Grupi ka të drejtë ligjore për të kompensuar shumat dhe ka për qëllim ose t'i mbyllë ato mbi një bazë neto, ose të realizojë shitjen e aktivitet dhe blerjen e detyrimit në të njëjtën kohë.

Instrumentet financiare jo-derivative maten fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e saj. Pas njohjes fillestare me vlerë të drejtë, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### *Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to*

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to përbëhen nga tepricat e parave të gatshme dhe depozitave pa afat, ose me maturim fillestar tre muaj ose më pak. Mjetet monetare mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

##### *Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjerat*

Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera janë aktive financiare me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë regjistruar në një treg aktiv. Aktive të tilla njihen fillimisht me vlerën e drejtë të tregut, plus çdo kosto transaksioni që lidhet drejtpërdrejt me to. Pas njohjes fillestare, llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera maten me metodën e koston së amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus çdo rënie të vlerës.

# American Hospital Sha

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara

(Shumat në '000 Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

---

### 3. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

#### (c) Instrumentet financiare (vazhdim)

##### *Detyrime financiare joderivative*

Grupi fillimisht njihet detyrimet financiare në datën e tregtimit, datë në të cilën Grupi bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Grupi çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shkarkohen, anulohen apo humbin vlefshmërinë e tyre.

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe paraqiten për shumën neto në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë, dhe vetëm atëherë kur Grupi ka të drejtë ligjore për të kompensuar shumat dhe ka për qëllim t'i mbyllë ato mbi një bazë neto, ose të realizojë shitjen e aktivitet dhe blerjen e detyrimit në të njëjtën kohë.

Grupi ka detyrime financiare jo derivative si vijon: hua, të pagueshme tregtare dhe të tjera dhe detyrime të tjera.

Detyrime të tilla financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë, plus çdo kosto transaksioni që lidhet drejtpërdrejtë më të. Pas njohjes fillestare këto detyrime financiare maten me metodën e koston së amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Trajtimi kontabël për të ardhurat dhe shpenzimet financiare shpjegohet në shënimin 5(l).

#### (d) Aktive afatgjata të trupëzuara

##### *Njohja dhe matja*

Aktivitet afatgjata të trupëzuara maten me koston minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Kosto e një njësie të aktiveve afatgjata të trupëzuara është çmimi i tij ekuivalent në para në datën e njohjes. Nëse pagesa është e shtyrë përtej kushteve normale të kreditimit, diferenca midis çmimit ekuivalent në para dhe pagesës totale njihet si interes gjatë periudhës së kreditimit. Kosto përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërsëdrejti me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë Grupi përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet drejtpërsëdrejti me përgatitjen e aktiveve në gjendje pune për qëllimin e përdorimit të tyre; shpenzimet e çmontimit dhe heqjes së elementëve dhe rikthimin e tokës në gjendjen origjinale, si dhe koston e kapitalizuara të huamarrjes (shih shënimin 5 (h)).

Programet (software) të blerë të cilët janë pjesë tërësore në funksionalitetin e pajisjeve përkatëse, kapitalizohen si pjesë e kësaj pajisjeje.

Kur pjesë të një objekti të aktiveve afatgjata të trupëzuara kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si objekte të veçanta (përbërës kryesorë) të aktiveve afatgjata të trupëzuara.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e një njësie të aktiveve afatgjata të trupëzuara përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën e mbartur të ndërtesës dhe pajisjeve, dhe janë njohur si të ardhura neto në kategorinë e të ardhurave të tjera, në fitim ose humbje.

##### *Kostot vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata të trupëzuara i shtohet vlerës së mbetur të elementit nëse është e mundur që përfitimet ekonomike në të ardhmen që lidhen me këtë element do të rrjedhin në Grup, dhe kostoja e tij mund të matet me saktësi. Vlera e mbetur e elementit të zëvendësuar çregjistrohet. Kostot e mirëmbajtjeve ditore të aktiveve afatgjata të trupëzuara njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

##### *Zhvlerësimi*

Zhvlerësimi llogaritet mbi vlerën totale, e cila është kosto e një aktivi ose çdo vlerë tjetër që e zëvendëson koston, minus vlerën e mbetur.

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën e llogaritjes mbi vlerën e mbetur, me përjashtim të zhvlerësimit të ndërtesave që përlllogaritet me metodën lineare përgjatë një periudhe prej 20 vitesh, bazuar në përqindjet vjetore të zhvlerësimit si më poshtë:

# American Hospital Sha

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara

(Shumat në '000 Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

---

### 3. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

#### (d) Aktive afatgjata të trupëzuara (vazhdim)

- Pajisje dhe instrumente 20%
- Mjete transporti 20%
- Mobilje dhe orendi 20%
- Kompjuterat dhe pajisje IT 25%

Përmirësimet e qiramarrjes zhvlerësohen brenda periudhës prej 5 deri në 20 vite, e cila është periudha më e shkurtër midis afatit të qirasë dhe jetëgjatësisë së tyre të dobishme. Toka dhe aktivet në proces nuk zhvlerësohen. Në përcaktimin e jetëgjatësisë së ndërtesave dhe paisjeve, Grupi merr në konsideratë aspektin teknologjik të paisjeve dhe faktin që Grupi operon në një industri ku përparimet teknologjike janë të shpejta dhe zhvillohen vazhdimisht.

Jetëgjatësitë e dobishme, metodat e zhvlerësimit, dhe vlerat e mbetura nëse janë të rëndësishme, shqyrtohen në çdo datë raportimi dhe rishikohen nëse është e nevojshme.

#### (e) Aktivet afatgjata të patrupëzuara

Aktivitetet e patrupëzuara të blera nga Grupi janë paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Shpenzimet vijuese për aktivet e patrupëzuara, kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktivin përkatës, me të cilin ato lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në momentin që ndodhin.

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke u bazuar në metodën e amortizimit zbritës me norma vjetore të cilat variojnë midis 25% dhe 33%.

#### (f) Aktivet e marra me qira

##### Percaktimi nëse marrëveshje përmban qira

Në fillim të marrëveshjes, Grupi përcakton nëse marrëveshja është ose përmban qira. Në fillim ose në momentin e rivlerësimit të marrëveshjes që përmban qira, Grupi ndan pagesat dhe konsideratat e tjera që kërkohen nga marrëveshja, në ato që lidhen me qiratë dhe pagesat për elementë të tjerë në bazë të vlerës relative. Nëse Grupi konkludon për një qira financiare që nuk është praktike për t'i ndare pagesat në mënyrë të besueshme, aktivi ose detyrimi njihen në një vlerë të barabartë me vlerën e drejtë të aktivitetit në fjalë; rrjedhimisht, detyrimi zvogëlohet kur pagesat bëhen dhe kostot financiare të ndërlidhura me detyrimin njihen duke përdorur normën në rritje të huave të Grupit.

##### Aktivitetet me qira

Qiratë, në kushtet e të cilave Grupi merr në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë, dhe/ose jetëgjatësia e marrëveshjes së qirasë është e njëjtë me jetën e aktivitetit në marrëveshjen e njëjtë, janë të klasifikuara si qira financiare. Pas njohjes fillestare, aktivi i marrë me qira, matet me një shumë të barabartë të vlerës më të vogël midis vlerës së drejtë dhe vlerës aktuale të pagesave minimale të qirasë. Pas njohjes fillestare, aktivi kontabilizohet në përputhje me politikën kontabël të zbatueshme për atë aktiv.

Qiratë e tjera janë qira financiare dhe nuk njihen në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar të Grupit në momentin që ndodhin.

##### Pagesat e qirasë

Pagesat e bëra për qira operative njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes. Nxitjet e pranuarat të qirasë njihen si pjesë integrale e shpenzimit të qirasë, përgjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes.

Pagesat minimale të qirasë të bëra në raport me qiranë financiare ndahen ndërmjet shpenzimeve financiare dhe zvogëlimit të detyrimit. Shpenzimi financiar i alokohet çdo periudhe përgjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes së qirasë për të përgatitur një normë periodike konstante interesi në balancën e mbetur të detyrimit.



# American Hospital Sha

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara

(Shumat në '000 Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

---

### 3. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

#### (g) Inventarët

Inventarët maten me vlerën më të ulët mes kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarit bazohet në metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin kostot e blerjes, kostot e prodhimit ose shndërrimit dhe kosto të tjera të kryera për sjelljen e tyre në vendin dhe gjendjen e gatshme për përdorim. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes gjatë rrjedhës së zakonshme të biznesit minus kostot e vlerësuara të përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

#### (h) Kontabilizimi i kostove të huamarrjes

Grupi kapitalizon kostot e huamarrjes që lidhen drejtpërsëdrejti me blerjen, ndërtimin apo prodhimin e një aktivi të kualifikuar, si pjesë e kostove të atij aktivi.

#### (i) Zhvlerësimi

##### *Aktivitet financiar*

Një aktiv financiar, i cili nuk regjistrohet me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave, vlerësohet në fund të çdo periudhe raportuese për të përcaktuar nëse ka evidencë objektive që tregon se mund të jetë i zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka një evidencë objektive që tregon se një ose më shumë ngjarjeve kanë pasur një efekt negativ në flukset e mjeteve monetare të ardhshme të vlerësuara të këtij aktivi.

Evidenca objektive që aktivitet financiar janë zhvlerësuar mund të përfshijë pamundësi apo vështirësi të një klienti për të realizuar pagesën, ristrukturim të një detyrimi ndaj grupit me kushtin që Grupi nuk do të marrë në konsideratë raste të tjera, ose të ketë tregues që klienti do të shpallë falimentimin.

Grupi konsideron evidencë të zhvlerësimit të llogarisë së kërkesave të arkëtueshme, si në nivel specifik të aktivitet ashtu edhe në grup. Të gjithë klientët individualisht të rëndësishëm vlerësohen për zhvlerësim specifik. Të gjithë klientët individualisht të rëndësishëm, të cilët nuk janë trajtuar si të zhvlerësuar specifikisht, vlerësohen në grup për ndonjë zhvlerësim që ka ndodhur, por nuk është identifikuar ende. Klientët që nuk janë individualisht të rëndësishëm vlerësohen në grupe bazuar në tipare të ngjashme rreziku.

Gjatë vlerësimit në grup, Grupi përdor të dhënat historike të probabilitetit të mospagesës, kohën e mbledhjes dhe shumën e humbjes së ndodhur, të rregulluar sipas gjykimeve të drejtimit nëse kushtet e tanishme ekonomike dhe të kreditimit janë të tilla që humbjet aktuale të kenë mundësi të jenë më të mëdha apo më të vogla sesa humbjet e vlerësuara nga të dhënat historike. Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitet financiar. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe paraqiten si llogari provizioni kundrejt llogarive të arkëtueshme. Një humbje nga zhvlerësimi mund të anulohet në fitim ose humbje nëse ulja në zhvlerësim ka ndodhur për shkak të një ngjarjeje të ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi.

##### *Aktivitet jo-financiare*

Vlerat e mbartura të aktiveve jo-financiare të Grupit, përveç inventarëve dhe aktiveve tatimore të shtyra, rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Nëse ka evidencë të tillë, atëherë vlera e rikuperueshme e aktivitet vlerësohet.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose njësie gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së tij të drejtë minus kostot për t'u shitur. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare skontohen për të dhënë vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të aktivitet. Me qëllim testimin për zhvlerësim, aktivitet që nuk mund të testohen në mënyrë individuale grupohen së bashku në grupin më të vogël të aktiveve që gjenerojnë flukse hyrëse monetare nga përdorimi i vijueshëm të cilat janë kryesisht të pavarura nga flukset hyrëse monetare të aktiveve të tjera apo grupeve të tjera të aktiveve ("njësisë gjeneruese e mjeteve monetare ose NJGJMM"). Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbartur e një aktivi ose NJGJMM e tejkalon shumën e rikuperueshme të vlerësuar. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në lidhje me NJGJMM shpërndahen për të zvogëluar vlerën e mbartur të aktivitet në njësi (grup njësis) në varësi të peshës së secilit. Humbja nga zhvlerësimi rishikohet në çdo datë raportimi për tregues që humbja është pakësuar ose nuk ekziston më. Humbja nga zhvlerësimi kthehet nëse ka patur një ndryshim në vlerësimin e përdorur për të përcaktuar vlerën e realizueshme. Humbja nga zhvlerësimi kthehet vetëm në masën, në të cilën vlera e mbartur e aktivitet nuk tejkalon vlerën e mbetur të tij që përcaktohet nga vlera neto e tij pas amortizimit, nëse nuk ka humbje nga zhvlerësimi.

# American Hospital Sha

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara

(Shumat në '000 Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

---

### 3. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

#### (j) Provizionet

Një provigjoni njihet kur Grupi, si pasojë e ngjarjeve të shkuara ka një detyrim aktual, ligjor ose strukturor, që mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të kërkohej një fluks dalës të mirash ekonomike për të shlyer detyrimin. Provigjonet llogariten duke skontuar flukset e ardhshme monetare me një normë përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Amortizimi i skontos njihet si kosto financiare.

#### (k) Të ardhurat

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose për tu arkëtuar dhe përfaqëson vlerën e arkëtueshme për të mirat dhe shërbimet e siguruara gjatë aktivitetit normal të biznesit, neto nga zbritjet dhe rabatet.

##### *Shërbimet*

Të ardhurat nga shërbimet e kryera njihen në pasqyrën e të ardhurave në përpjesëtim me fazën e përfundimit të transaksionit në datën e raportimit.

##### *Shitja e mallrave*

Të ardhurat njihen kur rreziqet dhe përfitimet e rëndësishme të pronësisë janë transferuar tek blerësi, mbledhja e tyre është e mundur; kostot e lidhura dhe kthimi i mundshëm i mallrave dhe shërbimeve mund të vlerësohen saktë; nuk ka përfshirje të vazhdueshme të drejtimit lidhur me mallrat dhe shërbimet; dhe shumat e të ardhurave mund të maten saktë. Koha e transferimit të rreziqeve dhe përfitimeve varet nga kushtet specifike të procesit të shitjes.

#### (l) Të ardhurat dhe kostot financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga fondet e investuara. Të ardhurat nga interesi njihen në bazë të përlllogaritjes në pasqyrën e të ardhurave, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Kostot financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë dhe kthimin e zbritjeve mbi provizionet. Kostot e huamarrjes, të cilat nuk janë të lidhura drejtpërsëdrejti me blerjet, ndërtimin ose prodhimin e një aktivi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Fitimet dhe humbjet nga veprimet në monedhë të huaj raportohen në baza neto.

#### (m) Përfitimet e punonjësve

##### *Planet e kontributeve të përcaktuara*

Grupi merr pjesë në kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore që japin përfitimet e pensionit për punonjësit e saj pas daljes në pension. Detyrime për kontribute të tilla për të përcaktuar planet e pensioneve njihen si shpenzime në fitim ose humbje, kur ka detyrim. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e pragut ligjor minimal për pensionet në kuadrin e një plani pensionesh të përcaktuar.

##### *Pagesat për lejet vjetore*

Grupi njihet si detyrim shumë të pazbritur për shpenzimet e vlerësuara e të lidhura me pushimet vjetore që priten të paguhet në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e përfunduar.

##### *Përfitime afatshkurtër*

Detyrimet afatshkurtra që punonjësit përfitojnë, maten në një bazë të pazbritur dhe njihen si shpenzime në momentin e kryerjes së shërbimit. Provizionet njihet për shumën që priten të paguhet në para të gatshme në formën e një shpërblimi afatshkurtër ose plani për ndarjen e fitimit, nëse Grupi ka një detyrim ligjor ose strukturor të paguajë këtë shumë, si rezultat i shërbimit, të ofruar nga punonjësi në të kaluarën dhe detyrimi mund të vlerësohet saktë.

#### (n) Tatimi mbi të ardhurat

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale njihet në pasqyrën e të ardhurave, përveç pjesës që lidhet me elementët që njihen direkt në llogarinë e kapitalit ose në të tjera të ardhura përmbledhëse.

##### *Tatim fitimi aktual*

Tatimi i periudhës aktuale është tatimi i pritshëm për t'u paguar ose për t'u arkëtuar nga të ardhurat e tatueshme ose humbja për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose të miratuara në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

# American Hospital Sha

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara

(Shumat në '000 Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

---

### 3. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

#### (n) Tatimi mbi të ardhurat (vazhdim)

##### *Tatimi i shtyrë*

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferenca të përkohshme ndërmjet vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerat e përdorura për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen mbi diferencat e përkohshme kur të kthehen, në bazë të ligjeve në fuqi ose të miratuara në datën e raportimit financiar. Në përcaktimin e vlerës së tatimit fitimit aktual dhe të shtyrë Grupi merr parasysh ndikimin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse mund të jenë të pagueshme taksa dhe interesa shtesë. Grupi beson se përlllogaritjet për detyrime tatimore janë të përshtatshme për të gjitha vitet, bazuar në vlerësimin e shumë faktorëve, duke përfshirë interpretime të ligjit të taksave dhe eksperiencës së mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në llogaritje dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme. Informacioni i ri që mund të vihet në dispozicion, mund të shkaktojë që Grupi të ndryshojë gjykimet në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime të tilla në detyrimet tatimore do të kenë ndikim mbi tatim fitimin në periudhat që ky përcaktim bëhet.

Aktivet tatimore të shtyra njihen në atë masë që është e mundur që do të ketë fitime të tatueshme në të ardhmen, kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

Aktivet dhe detyrimet e shtyra tatimore paraqiten neto në qoftë se ka një të drejtë të kërkueshme me ligj për të netuar aktivet dhe detyrimet aktuale tatimore, dhe ato lidhen me tatime mbi të ardhurat të vendosura nga i njëjti autoritet tatimor, për të njëjtin subjekt tatimor, ose mbi subjekte të ndryshme tatimore, por ata kanë për qëllim të shlyejnë detyrimet dhe aktivet aktuale tatimore në bazë neto, ose aktivet dhe detyrimet tatimore do të realizohen në të njëjtën kohë.

#### (o) Standardet dhe interpretimet e reja, ende të pazbatuara

Disa standarde të reja, ndryshime të standardeve ekzistuese dhe interpretime nuk janë ende në fuqi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017, dhe nuk janë zbatuar para kohe në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara. Standardet që mund të jenë relevante për Grupin janë paraqitur më poshtë:

##### ***SNRF 15 Të ardhurat nga Kontratat me Klientët***

SNRF 15 hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më dhe pas datës 1 janar 2018, duke lejuar dhe zbatimin më të hershëm. Standardi i ri zëvendëson udhëzimet ekzistuese për njohjen e të ardhurave sipas SNRF, duke përfshirë SNK 18 *Të ardhurat*, SNK 11 *Kontratat e Ndërtimit* dhe KIRFN 13 *Programet e Besnikërisë së Klientit*. Shoqëritë do të zbatojnë një model me pesë hapa për të përcaktuar kur duhet njohur e ardhura dhe në çfarë shume. Modeli i ri saktëson që e ardhura duhet të njihet kur (ose ndërkohë që) një njësi ekonomike transferon kontrollin mbi mallrat ose shërbimet tek një klient për shumën të cilën njësi ekonomike pret të ketë të drejtën të arkëtojë. Në varësi të përmbushjes së disa kriterëve, e ardhura njihet:

- përgjatë periudhës, në një mënyrë që pasqyron ecurinë e njësisë ekonomike; ose
- në një moment kohor, kur kontrolli mbi mallrat ose shërbimet i transferohet klientit.

SNRF 15 gjithashtu vendos parimet që një njësi ekonomike duhet të zbatojë për dhënien e shënimeve shpjeguese cilësore dhe sasiore që japin informacion të dobishëm për përdoruesit e pasqyrave financiare mbi natyrën, shumën, kohën dhe pasigurinë në lidhje me të ardhurat si dhe mbi flukset monetare nga kontratat me klientët.

Grupi ka përfunduar vlerësimin e tij fillestar të ndikimit të mundshëm të SNRF 15 mbi pasqyrat financiare të konsoliduara dhe drejtimi nuk pret që Standardi i ri, në momentin e zbatimit fillestar të tij, të ketë ndonjë ndikim material mbi pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit. Koha dhe matja e të ardhurave të Grupit nuk pritet të ndryshojnë me SNRF 15 për shkak të natyrës së veprimtarive të Grupit dhe llojit të të ardhurave që ajo/ai realizon.

Te ardhurat nga shitja e mallrave njihen në momentin në të cilin klienti pranon mallrat dhe rreziqet e përfitimit e lidhura me transferimin e pronësisë. Të ardhurat njihen në këtë moment me kusht që të ardhurat dhe shpenzimet mund të maten me besueshmeri, rekuperimi i shumës për t'u arkëtuar është i mundshëm dhe nuk do të ketë përfshirje të vazhdueshme menaxhimi mbi mallrat. Sipas SNRF 15, të ardhurat njihen kur një klient merr kontrollin mbi mallrat që nuk pritet të ndryshojnë kohën e njohjes së të ardhurave.

# American Hospital Sha

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara

(Shumat në '000 Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

---

### 3. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

#### (o) Standardet dhe interpretimet e reja, ende të pazbatuara (vazhdim)

##### *SNRF 15 Të ardhurat nga Kontratat me Klientët (vazhdim)*

Të ardhurat nga shërbimet e kujdesit shëndetësor aktualisht njihen duke përdorur metodën e fazës së përfundimit. Sipas SNRF 15, të ardhurat do të njihen përgjatë kohës, sipas treguesve të matjes së ecurisë përgjithësisht të ngjashme me metodën aktuale. Duke pasur parasysh natyrën rutinë dhe të vazhdueshme të këtyre shërbimeve, ku marrja dhe konsumimi i njëkohshëm i shërbimeve nga klientët ndodhin brenda një kohe të shkurtër, Grupi nuk pret që zbatimi i SNRF 15 të rezultojë në ndryshimin e kohës së njohjes së të ardhurave për këto shërbime.

##### *SNRF 9 Instrumentet Financiare*

SNRF 9, publikuar në korrik 2014, zëvendëson udhëzimet ekzistuese në *SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja*. SNRF 9 paraqet udhëzime të rishikuara mbi klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare, duke përfshirë një model të ri të humbjeve të pritshme të kredisë për llogaritjen e zhvlerësimit të aktiveve financiare, dhe kritere të përgjithshme të reja për kontabilitetin mbrojtës. SNRF 9 hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më dhe pas datës 1 janar 2018, duke lejuar dhe zbatimin më të hershëm. Megjithëse ende nuk ka përfunduar plotësisht vlerësimi fillestar i ndikimit të mundshëm të SNRF 9 në pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit, Grupi nuk pret që Standardi i ri, në momentin e zbatimit fillestar të tij të ketë ndonjë ndikim material mbi pasqyrat financiare të konsoliduara.

Më 31 dhjetor 2017, Grupi kishte një investim me pjesëmarrje në kapitalin e Dia-Vita sh.p.k. (shënimi 1) të matur me kosto. Sipas SNRF 9, Grupi do të masë këtë instrument kapitali me vlerë të drejtë dhe është duke përfunduar vlerësimin për modelin më të përshtatshëm të klasifikimit dhe matjes së tij sipas SNRF 9.

Humbjet e pritshme të kredisë (ECL) për të arkëtueshmet tregtare do të llogariten bazuar në përvojën aktuale të humbjes së kredisë gjatë viteve të fundit, marrë veçantë për korporatat dhe individët. Përvoja aktuale e humbjes së kredisë do të përshtatet me faktorë skalarë për të pasqyruar ndryshimet ndërmjet kushteve ekonomike gjatë periudhës për të cilën janë mbledhur të dhënat historike, kushteve aktuale dhe kushteve ekonomike që Grupi pret gjatë jetës së pritshme të të arkëtueshmeve. Faktorët skalarë do të bazohen tek PBB-ja dhe parashikimet për normën e inflacionit dhe parashikimet e industrisë.

##### *SNRF 16 Qiratë*

SNRF 16 zëvendëson udhëzimet ekzistuese për qiratë, duke përfshirë SNK 17 *Qiratë*, KIRFN 4 *Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një Qira*, KIS-15 *Qiratë Operative - Stimujt* dhe KIS-27 *Vlerësimi i Përmbajtjes së Transaksioneve që Përfshijnë Formën Ligjore të një Qiraje*. Standardi i ri sjell një model të vetëm kontabël të paraqitjes në bilanc të qirave nga qiramarrësit. Një qiramarrës njih një aktiv për të drejtën e përdorimit që përfaqëson të drejtën e tij të përdorimit të aktivitet bazë dhe një detyrim qiraje që përfaqëson detyrimin e tij për të bërë pagesa qiraje. Ka përjashtime nga njohja për qiratë afat-shkurtra dhe qiratë e aktiveve me vlerë të ulët. Kontabiliteti nga qiradhënësi mbetet i ngjashëm me standardin aktual – pra, qiradhënësit do të vazhdojnë të klasifikojnë qiratë si financiare ose operative. Standardi hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019 duke lejuar edhe zbatim më të hershëm për njësitë ekonomike që zbatojnë SNRF 15 në ose para datës së zbatimit fillestar të SNRF 16.

Grupi ka kryer një vlerësim fillestar të ndikimit të mundshëm të SNRF 16 mbi pasqyrat financiare të konsoliduara, por nuk ka kryer ende një vlerësim të detajuar. Ndikimi aktual i zbatimit të SNRF 16 mbi pasqyrat financiare të konsoliduara në periudhën e zbatimit fillestar do të varet nga kushtet e ardhshme ekonomike, duke përfshirë normën e huamarrjes së Grupit më 1 janar 2019, përbërjen e portofolit të qirave të Grupit në atë datë, vlerësimin më të fundit të Grupit nëse do të ushtrojë ndonjë nga mundësitë e rinovimit të qirave si dhe shkallën në të cilën Grupi do të zgjedhë të përdorë lehtësitë praktike dhe përjashtimet nga njohja.

Deri më tani, ndikimi më i rëndësishëm i identifikuar është se Grupi do të njohë aktive dhe detyrime të reja për shumicën e qirave të tij operative të ambjenteve spitalore dhe të poliklinikave. Për më tepër, natyra e shpenzimeve që lidhen me ato qira do të ndryshojë tashmë pasi SNRF 16 zëvendëson shpenzimet e njëtrajtshme të qirasë me shpenzimin e amortizimit të së drejtës së përdorimit të aktiveve me qira dhe shpenzimin e interesit mbi detyrimet e qirasë.

# American Hospital Sha

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara

(Shumat në '000 Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

---

### 3. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

#### (o) Standardet dhe interpretimet e reja, ende të pazbatuara (vazhdim)

##### Standarde dhe interpretime të tjera

Ndryshimet e mëposhtme në standarde dhe interpretime nuk pritet të kenë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit.

- Përmirësimet vjetore të SNRF: Periudha 2014-2016 - Ndryshime në SNRF 1 dhe SNK 28
- Klasifikimi dhe matja e transaksioneve të pagesave bazuar në aksione (Ndryshime në SNRF 2)
- Transferimi i aktiveve materiale afatgjata të investuara (Ndryshime në SNK 40)
- Shitja ose Kontributi i Aktiveve mes një Investitori dhe Pjesëmarrjes ose Sipërmarrjes së Përbashkët përkatëse (Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28)
- KIRFN 22 Transaksionet dhe Paradhëniet në Monedhë të Huaj
- KIRFN 23 Pasiguritë mbi Trajtimet e Tatimit mbi Fitimin
- Veçoritë e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNRF 9)
- Interesat Afatgjatë në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta (Ndryshimet në SNK 28)
- Përmirësimet vjetore të SNRF: Periudha 2015-2017 - Ndryshimet në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12, SNK 23
- Ndryshimet, Shkurtimeve ose Shlyerjet e Planit të Pensioneve (Ndryshimet në SNK 19).

#### 4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Grupi bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në pervojën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme në baze të rrethanave.

##### (a) Gjykimet

Informacioni në lidhje me gjykimet e bëra që kanë efektet më të rëndësishme në shumat e paraqitura në pasqyrat financiare është përfshirë në shënimet vijuese:

*Shënimi 1 Investimet në Dia-Vita Shpk* - Grupi analizoi faktet dhe rrethanat që kontribuojnë në një ndikim të rëndësishëm duke përfshirë faktorët cilësorë në SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta" dhe konstatoi se Grupi nuk ka ndikim të rëndësishëm mbi Dia-Vita sh.p.k.. Grupi nuk ka aplikuar metodën e kapitalit dhe investimi është vlerësuar me një kosto zero. Ky instrument kapitali vlerësohet me kosto ndaj vlerës së drejtë pasi investimi nuk ka një çmim kuotimi në një treg aktiv dhe vlera e drejtë e tij nuk mund të matet me besueshmëri.

*Shënimi 11 Qiraja financiare* – Grupi ka klasifikuar si qira financiare kontratën e qirasë për përdorimin e pajisjeve meqënëse kohëzgjatja e marrëveshjes është 5 vite, dhe konsiderohet të jetë pjesa më e madhe e jetës ekonomike të pajisjes, pavarësisht se pronësia nuk është transferuar.

*Shënimi 22 Kushtëzime dhe angazhime* – Grupi ka një marrëveshje qiraje për ndërtesën e spitalit Tirana III. Kohëzgjatja e qirasë është 30 vite. Kjo kontratë është klasifikuar si qira operative. Qëllimi i Grupit është ta konsiderojë si qira operative sepse nuk ka mundësi blerjeje lidhur me këtë marrëveshje. Pagesat e kontraktuara të qirasë janë 8% e të ardhurave mujore të muajit paraprak. Nuk ka pagesa minimale qiraje. Marrëveshja parashikon që 6 muajt e parë të qirasë të jenë falas, ndaj Grupi ka njohur shpenzime qiraje nisur nga maji 2017.

*Shënimi 22 Kushtëzime dhe angazhime* – Nisur nga viti 2015, filiali në Kosovë ka marrë me qira objektin spitalor për një periudhë maksimale prej 30 vitesh me mundësi rinovimi për 10 vite të tjera. Qiradhënësi dhe pronari i objektit ka marrë me qira tokën në të cilën ndodhet ndërtesa e Spitalit nga Komuna e Prishtinës, për një periudhë prej 10 vitesh, që përfundoi në shtator të vitit 2017 dhe u rinovua për një periudhë shtesë prej 10 vitesh, e parashikuar në marrëveshjen midis palëve. Secila palë mund ta ndërpresë marrëveshjen duke njoftuar 6 muaj përpara datës së përfundimit. Pas rinovimit të marrëveshjes së qirasë së tokës gjatë vitit 2017, Drejtimi ka rivlerësuar trajtimin e marrëveshjes së qirasë bazuar në informacionin e vënë në dispozicion. Bazuar në informacionet e fundit të disponueshme pas rinovimit të marrëveshjes së qirasë së tokës, drejtimi përcaktoi shpenzimet e qirasë për periudhën, duke përcaktuar shpenzimet mujore të qirasë të rëna dakort prej 15,000 Euro në pesë vitet e para të qirasë dhe 70,000 Euro në vitet në vijim. Grupi ka njohur shpenzimin e qirasë operative në mënyrë lineare përgjatë kohëzgjatjes së mbetur të marrëveshjes së qirasë, pas zgjatjes të periudhës së qirasë së tokës në 2017. Kjo ka shkaktuar shpenzime më të larta qiraje duke filluar nga viti 2017.

# American Hospital Sha

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara

(Shumat në '000 Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

---

### 4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

#### (b) Supozimet dhe pasiguritë e vlerësimeve

Informacionet lidhur me supozimet dhe vlerësimet e pasigurive që kane një rrezik të rëndësishëm dhe që mund të rezultojnë në një rregullim material në të ardhmen janë përshkruar më poshtë:

##### *Zhvlerësimi i pajisjeve*

Pavarësisht humbjeve të akumuluar (shihni shënimin 1), Drejtimi beson që Grupi është duke operuar në përputhje me buxhetin dhe pritshmëritë dhe do të jetë fitimprurës duke filluar nga viti 2018 dhe do të vijojë të gjenerojë të ardhura që do të jenë të mjaftueshme për të gjeneruar flukse monetare pozitive. Vlerësimi i vlerave të aktiveve afatgjata materiale është një çështje e gjykimit bazuar në pervojën, kushtet aktuale dhe pritshmëritë për të ardhmen me aktive të ngjashme. Në këto kushte, Drejtimi beson se vlera e aktiveve të Grupit nuk është zhvlerësuar më 31 dhjetor 2017.

##### *Llogaritja e tatimit mbi fitimin*

Drejtimi beson se llogaritja e tatimit mbi fitimin është e përshtatshme, pavarësisht pasigurive që ekzistojnë në mjedisin tatimor dhe në legjislacionin në fuqi dhe mendon se vizitat e ardhshme fiskale nuk do të sjellin efekte të rëndësishme në pasqyrën e pozicionit financiar të konsoliduar të Grupit, rezultatin nga aktiviteti apo në flukset monetare. Gjykimet dhe vlerësimet e bëra në lidhje me tatimin e shtyrë janë paraqitur në shënimin 20.

##### *Provizionet*

Për të përcaktuar nëse ndonjë provizion duhet të regjistrohet, Grupi bën gjykime nëse ka të dhëna të verifikueshme që tregojnë se ka ndonjë indikator të identifikuar dhe të matshëm të rrezikut në flukset e ardhshme monetare që lidhen me humbjet e mundshme dhe gjoba të lidhura me to. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna të verifikueshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim në kushtet ekonomike kombëtare ose lokale që lidhen me humbje potenciale. Drejtimi përdor vlerësime të bazuara në pervojën historike të humbjeve dhe dëshmi objektive të zhvillimeve aktuale të ngjashme, kur vlerëson flukset e ardhshme të parasë. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për vlerësimin e shumës dhe kohës se flukseve të ardhshme monetare rishikohen rregullisht për të reduktuar ndryshimet midis humbjeve të vlerësuar dhe humbjeve aktuale. Detaje të mëtejshme në lidhje me njohjen dhe matjen e provizioneve dhe kushtëzimeve si dhe supozimet kryesore në lidhje me gjasat dhe madhësinë e një fluksi dalës burimesh janë paraqitur në shënimin 22.

#### **Përcaktimi i vlerës së drejtë**

Një numër politikash dhe informacionesh shpjeguese kontabël të Grupit kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë si për aktivet dhe detyrimet financiare dhe ato jo-financiare. Vlerat e drejta janë përcaktuar për qëllime të matjes dhe/ose të paraqitjes, bazuar në metodat vijuese. Kur është i zbatueshëm, informacion më i detajuar për supozimet e bëra në përcaktimin e vlerave të drejta, paraqitet në shënime shpjeguese specifike lidhur me atë aktiv ose detyrim.

##### *Aktive financiare*

Vlera e mbetur e të gjitha aktiveve financiare është konsideruar e barabartë me vlerën e tyre të drejtë për shkak të natyrës afatshkurtër. Zhvlerësimi dhe shlyerja e llogarive të arkëtushme shpjegohet në shënimin 21.

##### *Detyrimet financiare jo-derivative*

Vlera e drejtë, e cila përcaktohet për qëllime të paraqitjes, është llogaritur bazuar në vlerën aktuale të flukseve të ardhshme monetare të principalit dhe interesit, të skontuara me normën e tregut në datën e raportimit. Vlera e mbartur e të gjitha detyrimeve financiare konsiderohet të jetë e barabartë me vlerën e tyre të drejtë për shkak të natyrës afatshkurtër, ose për shkak të normave të interesit që janë të përafërta me normat e tregut. Norma e interesit për huatë është e ndryshme nga norma e interesit e aplikueshme për të pagueshmet ndaj furnitorëve, duke marrë parasysh karakteristikat dhe specifikat e secilës formë financimi.

# American Hospital Sha

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara

(Shumat në '000 Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

### 5. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

	2017	2016
Arka	15,316	6,690
Banka	35,586	21,005
<b>Totali</b>	<b>50,902</b>	<b>27,695</b>

### 6. Kërkesa të arkëtueshme

	2017	2016
Të arkëtueshme nga kompanitë e tjera	81,591	191,321
Të arkëtueshme nga Fondi dhe Ministria e Shëndetësisë	94,880	145,625
Të arkëtueshme nga individët	100,776	96,758
	277,247	433,704
Fond zhvlerësimi i kërkesave të arkëtueshme	(72,510)	(66,878)
<b>Totali</b>	<b>204,737</b>	<b>366,826</b>

Gjatë vitit 2017, Grupi ka ofruar shërbime kryesisht në fushën e kardiologjisë dhe kardio-kirurgjisë për një numër të madh të pacientëve që subvencionohen nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës. Për më tepër, Grupi ka shtuar shërbimet e dhëna kundrejt Fondit Shtetëror të Sigurimit Shëndetësor në Shqipëri ("Fondi").

Klasifikimi i disa shifrave krahasuese sipas llojit të konsumatorit ka ndryshuar në përputhje me prezantimin e vitit aktual. Si rezultat, një shumë prej 9,468 mijë Lek, e klasifikuar më parë si e arkëtueshme nga kompani të tjera, përfshihet në shumën krahasuese të paraqitur si të arkëtueshme nga Fondi dhe Ministria e Shëndetësisë. Lëvizja në fondin e zhvlerësimit të kërkesave të arkëtueshme paraqitet si më poshtë:

	2017	2016
Shuma në fillim të vitit	66,878	62,667
Humbje të njohura për kërkesat e arkëtueshme	20,530	17,480
Shuma të fshira gjatë vitit si të pambledhshme	(14,898)	(13,269)
<b>Shuma në fund të vitit</b>	<b>72,510</b>	<b>66,878</b>

Informacioni rreth ekspozimit të Grupit ndaj rrezikut të kredisë për të arkëtueshmet paraqitet në Shënimin 21 (ii).

### 7. Inventarë

	2017	2016
Të konsumueshme	213,698	244,715
Materiale të tjera	54,752	49,862
Medikamente	27,688	31,071
Mallra	24,936	25,781
Karburant	4,940	6,849
<b>Totali</b>	<b>326,014</b>	<b>358,278</b>

### 8. Aktive të tjera

	2017	2016
Taksa të parapaguara për çështje specifike	61,978	61,996
Depozita paguar furnitorëve	4,636	7,339
Parapagime dhe paradhënie	3,643	6,792
Aktive të tjera	22,866	9,985
<b>Totali</b>	<b>93,123</b>	<b>86,112</b>

Grupi ka parapaguar shumën e detyrimit tatimor prej 61,978 Lek (2016: 61,996 Lek), që përbëhet nga detyrime dhe gjoba si rezultat i raportit të inspektimit tatimor të datës 4 mars 2016. Grupi ka filluar procedura gjyqësore për të kundërshtuar këtë detyrim dhe rasti është fituar në shkallë të parë. Grupi ka njohur provizione për shumat e parapaguara dhe për interesat të lidhur me pagesat e vonuara.

# American Hospital Sha

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara

(Shumat në '000 Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

### 9. Aktivet afatgjata të trupëzuara

	Toka	Ndërtesa dhe përmirësime të qiramarrjes	Pajisje dhe instrumente	Mjete transporti	Mobilje dhe pajisje elektronike	Aktive në proces	Totali
<b>Kosto</b>							
Më 31 dhjetor 2015	<b>98,704</b>	<b>1,644,429</b>	<b>2,044,320</b>	<b>34,991</b>	<b>294,188</b>	<b>5,224</b>	<b>4,121,856</b>
Shtesa	-	54,675	227,186	2,752	51,735	(2,911)	333,437
Shitje dhe pakësime	-	(60)	(40,776)	(8,854)	(9,592)	-	(59,282)
Diferenca konvertimi	-	(3,955)	(18,022)	-	(1,769)	(67)	(23,813)
Më 31 dhjetor 2016	<b>98,704</b>	<b>1,695,089</b>	<b>2,212,708</b>	<b>28,889</b>	<b>334,562</b>	<b>2,246</b>	<b>4,372,198</b>
Shtesa	-	27,591	293,955	4,740	50,073	138,726	515,085
Shitje dhe pakësime	-	(34,736)	(135,974)	(1,478)	(14,288)	(79)	(186,555)
Diferenca konvertimi	-	(4,518)	(9,816)	(34)	(2,146)	(26)	(16,540)
Më 31 dhjetor 2017	<b>98,704</b>	<b>1,683,426</b>	<b>2,360,873</b>	<b>32,117</b>	<b>368,201</b>	<b>140,867</b>	<b>4,684,188</b>
<b>Zhvlerësimi i akumuluar</b>							
Më 31 dhjetor 2015	-	<b>(334,007)</b>	<b>(1,055,486)</b>	<b>(22,364)</b>	<b>(103,428)</b>	-	<b>(1,515,285)</b>
Shpenzimi për vitin	-	(92,994)	(228,546)	(2,674)	(44,276)	-	(368,490)
Shitje dhe pakësime	-	13	33,057	7,460	8,253	-	48,783
Diferenca konvertimi	-	450	12,463	3	484	2	13,402
Më 31 dhjetor 2016	-	<b>(426,538)</b>	<b>(1,238,512)</b>	<b>(17,575)</b>	<b>(138,967)</b>	<b>2</b>	<b>(1,821,590)</b>
Shpenzimi për vitin	-	(94,075)	(208,309)	(2,386)	(46,105)	-	(350,875)
Shitje dhe pakësime	-	11,066	49,546	1,041	12,205	-	73,858
Diferenca konvertimi	-	723	4,168	7	682	-	5,580
Më 31 dhjetor 2017	-	<b>(508,824)</b>	<b>(1,393,107)</b>	<b>(18,913)</b>	<b>(172,185)</b>	<b>2</b>	<b>(2,093,027)</b>
<b>Vlera e mbartur</b>							
Më 31 dhjetor 2015	98,704	1,310,422	988,834	12,627	190,760	5,224	2,606,571
Më 31 dhjetor 2016	98,704	1,268,551	974,196	11,314	195,595	2,248	2,550,608
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>98,704</b>	<b>1,174,602</b>	<b>967,766</b>	<b>13,204</b>	<b>196,016</b>	<b>140,869</b>	<b>2,591,161</b>

Më 31 dhjetor 2017, aktivet me vlerë të mbartur prej 645,736 mijë Lek (31 dhjetor 2016: 633,735 mijë Lek) janë vendosur si kolateral për hua bankare.



# American Hospital Sha

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara

(Shumat në '000 Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

### 10. Aktivet afatgjata të patrupëzuara

	Programe kompjuterike
<i>Kosto</i>	
<b>Më 31 dhjetor 2015</b>	<b>37,302</b>
Shtesat	5,390
Shitje dhe pakësime	(784)
Diferenca konvertimi	(161)
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>41,747</b>
Shtesat	3,703
Diferenca konvertimi	(194)
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>45,256</b>
<i>Amortizimi i akumuluar</i>	
<b>Më 31 dhjetor 2015</b>	<b>(19,433)</b>
Shpenzimi për vitin	(6,355)
Shitje dhe pakësime	550
Diferenca konvertimi	336
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>(24,902)</b>
Shpenzimi për vitin	(4,890)
Diferenca konvertimi	146
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>(29,646)</b>
<i>Vlera e mbartur</i>	
Më 31 dhjetor 2015	17,869
Më 31 dhjetor 2016	16,845
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>15,610</b>

### 11. Detyrime tregtare dhe të tjera

Detyrimet tregtare dhe të tjera përfshijnë si më poshtë:

	2017	2016
Të pagueshme ndaj furnitorëve për pajisje	697,047	634,046
Të pagueshme tregtare	492,310	465,206
Parapagime	131,552	61,444
Qira financiare	-	92,933
<b>Totali</b>	<b>1,320,909</b>	<b>1,253,629</b>
<b>Afatshkurtër</b>	<b>853,701</b>	<b>700,886</b>
Të pagueshme ndaj furnitorëve për pajisje	229,839	161,425
Të pagueshme tregtare	492,310	465,206
Parapagime	131,552	61,444
Qira financiare	-	12,811
<b>Afatgjatë</b>	<b>467,208</b>	<b>552,743</b>
Të pagueshme ndaj furnitorëve për pajisje	467,208	472,621
Qira financiare	-	80,122
<b>Totali</b>	<b>1,320,909</b>	<b>1,253,629</b>

Të pagueshme ndaj furnitorëve për pajisje më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, janë të pagueshme ndaj furnitorëve për pajisje të blera nga Grupi, të cilat janë të pagueshme në këste të barabarta mujore përgjatë viteve nga 2018 deri më 2022. Detyrime të tilla janë njohur fillimisht në një vlerë që përafrohet me çmimin aktual të pajisjes së blerë nga Grupi, dhe më pas maten sipas kostos së amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Parapagimet me 31 Dhjetor 2017 përfshijnë parapagimet e marra nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës në vlerë prej 72,946 mijë Lek (31 dhjetor 2016: 42,151 mije Lek), ndërsa pjesa e mbetur përbehet nga parapagimet nga pacientët.

## American Hospital Sha

### Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara

(Shumat në '000 Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

#### 12. Huatë

	2017	2016
<b>Afatshkurtër</b>		
Raiffeisen Bank Sh.a.	401,475	312,218
<b>Totali</b>	<b>401,475</b>	<b>312,218</b>

Huatë janë në Euro dhe maturohen në dhjetor 2018. Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, norma efektive e interesit 12 mujor Euribor ishte +4.5%, por jo më pak se 4.9% në vit. Më 31 dhjetor 2017, Grupi ka një shumë kredie të papërdorur prej 486 mijë Lek (31 dhjetor 2016: 191 mijë Lek) për qëllime të kapitalit punues.

#### Rakordimi i lëvizjeve të detyrimeve ndaj flukseve të mjeteve monetare që rrjedhin nga aktivitetet e financimit

Në mijë Lek	Furnitorët për pajisjet	Qira financiare	Hua	Totali
<b>Balanca më 1 janar 2017</b>	634,046	92,933	312,218	<b>1,039,197</b>
<b>Ndryshimet nga financimi i flukseve të mjeteve monetare</b>				
Të ardhurat nga huatë	-	-	89,257	<b>89,257</b>
Pagesa të detyrimeve nga qiraja	-	(8,834)	-	<b>(8,834)</b>
Shlyerje të të pagueshmeve ndaj furnitorëve të paisjeve	(138,351)	-	-	<b>(139,371)</b>
<b>Ndryshimet totale nga financimi i flukseve të mjeteve monetare</b>	<b>(139,371)</b>	<b>(8,834)</b>	<b>89,257</b>	<b>(58,948)</b>
<b>Ndryshime të tjera</b>				
Blerjet jo-monetare të pajisjeve	201,352	-	-	<b>201,352</b>
Ndërprerja e qirasë financiare	-	(84,099)	-	<b>(84,099)</b>
Shpenzime interesi	76,710	14,587	27,689	<b>118,986</b>
Interesa të paguar	(76,710)	(14,587)	(27,689)	<b>(118,986)</b>
<b>Balanca më 31 dhjetor 2017</b>	<b>697,047</b>	<b>-</b>	<b>401,475</b>	<b>1,098,522</b>

#### 13. Detyrime të tjera

Detyrime të tjera përbëhen si më poshtë:

	2017	2016
Provizione	109,147	93,517
Shpenzime të përlogaritura të incentivave të qirasë	49,329	-
Sigurime shoqërore dhe taksa të pagueshme	35,945	28,665
Shpenzime të përlogaritura	30,119	24,869
Detyrime ndaj personelit	23,427	21,992
Të ardhura të shtyra	21,313	13,260
TVSH e pagueshme	1,201	2,487
Kreditorë të ndryshëm	4,899	1,885
<b>Totali</b>	<b>275,380</b>	<b>186,675</b>

Më poshtë mund të shihet lëvizja në provizione:

	Provizion për çështje fiskale	Provizione të tjera	Total
Gjendja më 31 dhjetor 2015	<b>64,715</b>	<b>2,605</b>	<b>67,320</b>
Provizionet e njohura gjatë vitit	10,500	18,301	28,801
Provizionet e kthyera gjatë vitit	-	(2,604)	(2,604)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2016</b>	<b>75,215</b>	<b>18,302</b>	<b>93,517</b>
Provizionet e njohura gjatë vitit	-	16,210	16,210
Provizionet e kthyera gjatë vitit	-	(580)	(580)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>75,215</b>	<b>33,932</b>	<b>109,147</b>

# American Hospital Sha

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara

(Shumat në '000 Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

### 14. Kapitali aksionar

Balkan Alliance Healthcare B.V. u regjistrua në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si aksionari i vetëm i Grupit më 21 gusht 2008. Më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016, kapitali aksionar i regjistruar është i ndarë në 293,095 aksione me vlerë nominale nga 10,000 Lek. Struktura aksionare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 është si më poshtë:

	2017		2016	
	Në %	Në Lek '000	Në %	Në Lek '000
Balkan Alliance Healthcare B.V.	100	2,930,952	100	2,930,952
<b>Totali</b>	<b>100</b>	<b>2,930,952</b>	<b>100</b>	<b>2,930,952</b>

### 15. Të ardhurat

	2017	2016
Sherbime spitalore	1,675,270	1,396,184
Sherbime ambulatorë	875,465	696,356
Hemodializë	800,531	789,691
Laborator	658,831	498,198
Mallrat e shitura	390,467	355,973
Radiologji	390,209	380,226
Kardiologji	387,513	401,988
Ambulancë dhe shërbime emergjence	67,189	63,808
Farmaci	61,629	63,030
	5,307,104	4,645,454
Zbritjet	(65,456)	(76,497)
<b>Totali</b>	<b>5,241,648</b>	<b>4,568,957</b>

Të hyrat në bazë të llojit të klientëve, përbëhen si vijon:

	2017	2016
Kompani	345,026	320,480
Institucione qeveritare	1,020,871	1,146,824
Individë	3,941,207	3,178,150
<b>Totali</b>	<b>5,307,104</b>	<b>4,645,454</b>

### 16. Kosto e materialeve dhe mallrave

	2017	2016
Të konsumueshme	1,065,701	939,314
Medikamente	254,134	223,534
Mallra	167,768	153,053
Materiale të tjera	92,662	61,243
Karburant	64,081	39,119
	1,644,346	1,416,263
Zbritjet	(7,439)	(3,862)
<b>Totali</b>	<b>1,636,907</b>	<b>1,412,401</b>

### 17. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit përfshijnë si më poshtë:

	2017	2016
Pagat	1,617,980	1,346,588
Kontributet shoqërore dhe shëndetësore	146,098	110,797
Kosto të trajnimit dhe kosto të tjera personeli	4,757	3,490
<b>Totali</b>	<b>1,768,835</b>	<b>1,460,875</b>

Më 31 dhjetor 2017, Grupi kishte të punësuar 1,607 punonjës (31 dhjetor 2016: 1,394 punonjës).

# American Hospital Sha

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara

(Shumat në '000 Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

### 18. Shpenzime të tjera operative

Shpenzimet e tjera operative janë paraqitur si më poshtë:

	2017	2016
Shërbime profesionale, auditim dhe konsultime	692,206	551,753
Pastrim dhe trajtim i mbetjeve spitalore, shërbime utilitare	284,014	194,024
Qira	237,902	101,403
Marketing, reklama, publicitet	144,120	132,361
Mirëmbajtje ndërtese dhe pajisje	111,718	88,803
Ushqime dhe të tjera	52,375	42,898
Humbje nga shitja e aktiveve	33,693	8,741
Transport dhe udhëtime	27,515	19,705
Komunikim	19,825	18,234
Shërbime të tjera	18,496	6,795
Provizion për çështje ligjore e fiskale (shënimi 13)	16,210	26,197
Taksa dhe detyrime doganore	14,583	9,019
Marrëdhënie me publikun dhe të tjera të kësaj natyre	13,346	10,489
Komisione bankare	10,533	7,616
Materiale zyre dhe higjienike	4,431	11,498
Shërbime sigurie	9,164	8,957
Sigurime	6,924	5,381
Shpenzime të tjera	11,478	14,955
<b>Totali</b>	<b>1,708,533</b>	<b>1,258,829</b>

Rritja e shpenzimeve operative i atribuohet kryesisht fillimit të veprimtarisë së spitalit të ri në Tiranë në nëntor 2016 dhe rritjes së kostove të qirasë operative për spitalin në Kosovë.

### 19. Kosto financiare neto

Kostot financiare neto përbëhen si më poshtë:

	2017	2016
<i>Të ardhura financiare</i>		
Të ardhura nga interesi	2,734	398
	2,734	398
<i>Kostot financiare</i>		
Humbje neto nga kurset e këmbimit	(2,420)	(3,173)
Shpenzime interesi	(118,986)	(109,848)
	(121,406)	(113,021)
<b>Totali</b>	<b>(118,672)</b>	<b>(112,623)</b>

### 20. Tatimi mbi fitimin

	2017	2016
Tatim i vitit actual	-	40,436
(Përfitimi) për tatimin e shtyrë/ shpenzimi	(24,725)	-
<b>Totali i (përfitimit) tatimor/shpenzimit</b>	<b>(24,725)</b>	<b>40,436</b>

Grupi përcakton tatimin në fund të vitit në përputhje me legjislacionin tatimor përkatës. Në vitin 2017 dhe 2016, norma e tatimit mbi fitimin në Kosovë ishte e barabartë me 10% të fitimit të tatueshëm. Norma e tatimit mbi fitimin në Shqipëri është 15% për vitin 2017 dhe 2016.

# American Hospital Sha

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara

(Shumat në '000 Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

### 20. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Më poshtë është një rakordim i tatimit mbi fitimin i përlogaritur me normën tatimore në fuqi për shpenzimin e tatim fitimit:

	Norma tatimore	2017	Norma tatimore	2016
Humbja para taksave		(338,282)		(48,208)
Tatim i llogaritur me 15%	15.00%	(50,742)	15.00%	(7,231)
Efekti i normës së tatimit nën legjislacionin e huaj	(1.20%)	4,044	(13.7%)	6,597
Efekti tatimor nga:				
Shpenzime të panjohura për qëllime të tatimit	(6.40%)	21,576	(50.4%)	24,291
Diferenca të përkohshme të panjohura	(2.90%)	9,848	(18.1%)	8,733
Njohja e humbjeve fiskale të panjohura të kaluara	(11.82%)	39,999	-	-
Humbje fiskale të panjohura	-	-	(16.7%)	8,046
<b>Tatimi mbi fitimin aktual</b>	<b>(7.30%)</b>	<b>24,725</b>	<b>(83.9%)</b>	<b>40,436</b>

Tatimi i shtyrë është llogaritur bazuar në normën e miratuar tatimore prej 15% (2016: 15%). Diferencat e mëparshme të panjohura përfshijnë diferencat që lidhen me humbjet tatimore të mbartura që përfaqësojnë humbjet e tatueshme të bëra nga Grupi dhe të mbartura në periudhat e ardhshme. Periudhat e mbartura për çdo humbje tatimore në përputhje me ligjet në Shqipëri dhe Kosovë janë tre vjet dhe gjashtë vjet respektivisht. Asnjë aktiv i tatimit të shtyrë nuk ishte njohur në lidhje me humbjet tatimore të mbartura më 31 dhjetor 2016, për shkak të faktit se nuk ishte e sigurt se këto aktive tatimore të shtyra do të shfrytëzoheshin.

Pas rritjes së vazhdueshme të të ardhurave, përgjithësisht në përputhje me buxhetet (shih Shënimin 1) në vitin 2017, drejtimi rishikoi vlerësimet e tij mbi fitimet e tatueshme në të ardhmen dhe Grupi njohu efektin tatimor të humbjeve tatimore të panjohura më parë, sepse drejtimi konsideron se është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i vlefshëm kundrejt të cilit mund të përdoren këto aktive tatimore të shtyra. Aktivitet tatimore të shtyra janë njohur në masën që realizimi i përfitimit tatimor përkatës është i mundshëm.

Humbjet tatimore të panjohura më 31 dhjetor 2017 në vlerën 570,583 mijë lekë (2016: 455,355 mijë lekë) përfaqësojnë humbjet tatimore të Grupit në Shqipëri dhe të Filialit në Kosovë, në shumën 75,021 mijë lekë (2016: zero) dhe 495,562 lekë (2016: Lek 455,355 mijë), respektivisht. Humbjet tatimore të mbartura më 31 dhjetor 2017 janë të detajuara si më poshtë:

	Humbja tatimore për vitin	Shfrytëzimi	Humbje tatimore të mbartura
Viti 2017	115,228	-	570,583
Viti 2016	80,450	-	455,355
Viti 2015	200,762	-	374,905
Viti 2014	53,322	-	174,143
Viti 2013	14,541	-	120,821
Viti 2012	106,280	-	106,280

Shpenzimet e pazbritshme – diferenca të përkohshme prej 9,848 mijë lekë lidhen me zëra të njohura në fitim humbje për qëllime kontabiliteti dhe që për qëllime fiskale mund të zbriten nga rezultatet e tatueshme në të ardhmen. Rezultati i një çështjeje të tillë është i pasigurt pasi i nënshtrohet vlerësimeve të ardhshme të autoriteteve tatimore.

Aktivitet e shtyra tatimore, të paregjistruara më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, janë detajuar si më poshtë:

	2015	Lëvizjet	2016	Lëvizjet	2017
<b>Aktive të shtyra tatimore</b>					
Të arkëtueshme nga pacientë	14,807	(7,560)	7,247	2,744	9,991
Inventarë	4,678	1,283	5,961	(89)	5,873
Aktive afatgjata të trupëzuara	38,457	15,289	53,746	(21,827)	31,919
Të pagueshme ndaj furnitorëve për pajisje	(34,117)	2,486	(31,631)	7,671	(23,960)
Provizione	10,013	3,805	13,818	2,432	16,250
Shpenzime të llogaritura (stimujt e qirasë)	-	-	-	4,977	4,977
Qira financiare	-	(13,940)	(13,940)	13,940	-
<b>Totali i aktiveve të shtyra tatimore</b>	<b>33,839</b>	<b>1,363</b>	<b>35,202</b>	<b>9,848</b>	<b>45,050</b>

# American Hospital Sha

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara

(Shumat në '000 Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

### 21. Instrumente financiare – vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut

#### Administrimi i rrezikut financiar

Grupi është i ekspozuar ndaj rreziqeve nga përdorimi i instrumenteve të saj financiarë:

- Rreziku i kredisë
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i tregut
- Rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Grupit ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërm, objektivat, politikat dhe proceset e tij për matjen dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit të tij.

#### (i) Kuadri i menaxhimit të rrezikut

Këshilli Drejtues (“Këshilli”) mbart përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen dhe mbikëqyrjen e politikave të Grupit për menaxhimin e rrezikut. Këshilli gjithashtu është përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të Grupit për menaxhimin e rrezikut.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Grupit janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet, me të cilat ai përballet, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Grupi, përmes standardeve dhe procedurave të drejtimit synon të zhvillojë një mjedis kontrolli strukturor dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Drejtimi i Grupit kryen monitorimin e përditshëm të gjitha pozicioneve të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, përmes zbatimit të praktikave më të mira. Bazuar në analizën e përfitueshmërisë, likuiditetit dhe kostove të financimeve, drejtimi ndërmerr masa në lidhje me rreziqet e kredisë, tregut dhe likuiditetit, duke kufizuar kështu efektet e mundshme negative për shkak të pasigurisë financiare të jashtme. Në këtë mënyrë Grupi i përgjigjet sfidave të mjedisit të tregut dhe ruan një pozicion të qëndrueshëm të kapitalit dhe të likuiditetit.

#### (ii) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Grupit nëse një klient ose një palë e instrumentit financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale që lindin kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Grupit. Për qëllime të raportimit të drejtimit të rrezikut, grupi i konsideron këto elemente të ekspozimit të rrezikut të kredisë (të tilla si rreziku humbjes së aftësisë paguese individuale, rreziku i shërbimeve për spitalet shtetërore dhe shoqëritë e tjera).

Këshilli i Grupit ka deleguar autoritetin për drejtimin e rrezikut të kredisë tek drejtimi, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e rrezikut të kredisë për Grupin.

Është politikë e Grupit që të mbledhë në avancë shërbimet e faturuara nga pacientet, ose duke pranuar depozita nga ta, ndërkaq për disa nga pacientet/debitorët që dështojnë të paguajnë për shërbimet, Grupi fillon procedurat e mbledhjes së të arkëtueshmeve përmes gjyqit ose procedurave detyruese, bazuar në politikën përkatëse të mbledhjes së llogarive të arkëtueshme.

Llogaritë e arkëtueshme financiare janë detajuar si në vijim:

31 dhjetor 2017	Llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017			
	Individë	Njesi shtetërore	Shoqëri të tjera	Totali
Deri në 180 ditë	40,681	94,880	69,176	204,737
Mbi 180 ditë	60,095	-	12,415	72,510
<b>Totali</b>	<b>100,776</b>	<b>94,880</b>	<b>81,591</b>	<b>277,247</b>
Shuma të parashikuara për humbje	(60,095)	-	(12,415)	(72,510)
<b>Llogari të arkëtueshme neto</b>	<b>40,681</b>	<b>94,880</b>	<b>69,176</b>	<b>204,737</b>

31 dhjetor 2016	Llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016			
	Individë	Njesi shtetërore	Shoqëri të tjera	Totali
Deri në 180 ditë	45,205	145,625	174,003	364,833
Mbi 180 ditë	51,553	-	17,318	68,871
<b>Totali</b>	<b>96,758</b>	<b>145,625</b>	<b>191,321</b>	<b>433,704</b>
Shuma të parashikuara për humbje	(51,549)	-	(15,329)	(66,878)
<b>Llogari të arkëtueshme neto</b>	<b>45,209</b>	<b>145,625</b>	<b>175,992</b>	<b>366,826</b>

# American Hospital Sha

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara

(Shumat në '000 Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

### 21. Instrumente financiare –vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

#### Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

##### (ii) Rreziku i kredisë( vazhdim)

Shumica e llogarive të arkëtueshme nga institucionet shtetërore janë ripaguar gjatë tremujorit të parë të vitit 2017.

##### Llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësuara

Llogaritë e arkëtueshme për të cilat Grupi përcakton se nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjithë shumat e pashlyera sipas kushteve kontraktuale të marrëveshjes(ve), janë të zhvlerësuara.

##### Fondet për zhvlerësimin

Grupi vendos një fond për humbjet nga rënia në vlerë, e cila përfaqëson vlerësimin e tij të humbjeve të ndodhura në portofolin e tij. Elementi kryesor i këtij fondi lidhet me fondin kolektiv për humbjet nga rënia në vlerë, vendosur nga Grupi për aktivet homogjene përsa i përket humbjeve që kanë ndodhur në llogaritë e arkëtueshme.

##### Politika e çregjistrimit

Grupi çregjistron llogaritë e arkëtueshme (dhe çdo shumë përkatëse të parashikuar për humbjet nga rënia në vlerë), në kohën kur drejtimi vendos se llogaritë e arkëtueshme janë të pambledhshme. Ky përcaktim është arritur pasi janë marrë në konsideratë informacione si përpjekjet e rëndësishme që janë ndërmarrë për të arritur të mblidhen llogaritë e arkëtueshme, dhe nuk ka mundësi të tjera për mbledhjen e tepërave gjendje.

##### (iii) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Grupi do të hasë vështirësi në plotësimin e angazhimeve nga detyrimet e tij financiare.

##### Administrimi i rrezikut të likuiditetit

Pikëpamja e Grupit për menaxhimin e likuiditetit është që të sigurojë, aq sa është e mundur, që ai do të ketë gjithmonë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e tij në kohën e duhur, në kushte si normale ashtu edhe jo normale, pa shkaktuar humbje të papranueshme dhe pa rrezikuar dëmtimin e reputacionit të tij.

Tabela e mëposhtme tregon afatet e mbetura kontraktuale të detyrimeve financiare në datën e raportimit:

#### 31 dhjetor 2017

	Vlera e mbetur	Flukset kontraktuale të skontuara				Më shumë se një vit
		Totali	deri më 3 muaj	3 deri ne 6 muaj	6 deri në 12 muaj	
<b>Detyrimet financiare</b>						
Të pagueshme ndaj furnitorëve për pajisje	697,047	697,047	98,670	74,231	56,938	467,208
Të pagueshme tregtare	492,310	492,310	484,447	4,171	3,692	-
Huatë	401,475	401,475	-	-	401,475	-
	<b>1,590,832</b>	<b>1,590,832</b>	<b>583,117</b>	<b>78,402</b>	<b>462,105</b>	<b>467,208</b>

# American Hospital Sha

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara

(Shumat në '000 Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

### 21. Instrumente financiare –vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

#### Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(iii) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

31 dhjetor 2016

	Vlera e mbetur	Totali	Flukset kontraktuale të skontuara			Më shumë se një vit
			deri më 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	
<b>Detyrimet financiare</b>						
Të pagueshme ndaj furnitorëve për pajisje	634,046	634,046	25,735	21,292	114,398	472,621
Të pagueshme tregtare	465,206	465,206	439,586	4,197	21,423	-
Qira financiare	92,933	92,933	12,811			80,122
Huatë	312,218	312,218	-	-	312,218	-
	<b>1,504,403</b>	<b>1,504,403</b>	<b>478,132</b>	<b>25,489</b>	<b>448,039</b>	<b>552,743</b>

Detyrimet afatgjata janë bazuar në marrëveshje dhe skedule pagesash përkatëse të dakorduara me palë të treta. Në vijim të fazës fillestare dhe hapjes së spitalit të ri në Kosovë (shih Shënimin 1), Drejtimi beson se Filiali dhe Grupi do të jenë në gjendje të paguajnë detyrimet duke përdorur flukset e pritshme hyrëse nga të ardhurat dhe në vazhdim do të gjenerojnë flukse pozitive të parasë.

(iv) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i ndryshimit të çmimeve të tregut, siç janë kurset e këmbimit, normat e interesit dhe çmimet e kapitalit që do të ndikojnë të ardhurat e Grupit ose vlerën e instrumenteve financiare që mban ai. Objektivi i menaxhimit të rrezikut të tregut është për të menaxhuar dhe kontrolluar ekspozimet e rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin.

Rreziku i kursit të këmbimit

Kjo është një formë e rrezikut që rrjedh nga ndryshimi i çmimit të një monedhe kundrejt një tjetre. Rreziku i monedhës është menaxhuar duke monitoruar pozicionet e hapura valutore. Rreziku i monedhës drejtohet duke përdorur parimet e përputhjes aktive/detyrime dhe përmes kontributeve të pronarëve. Grupi nuk ka pasur ndonjë transaksion kontratë këmbimi forward apo produkte derivative të trupëzuar në kontrata më 31 dhjetor 2017 dhe 2016.

Tabela në vazhdim paraqet shumën ekuivalente në Lek të aktiveve dhe detyrimeve financiare sipas valutave më 31 dhjetor 2017 dhe 2016:

	31 dhjetor 2017			
	Lek	USD	Euro	Totali
<b>Aktivet financiare</b>				
Mjete monetare e ekuivalente	10,253	1,674	38,975	50,902
Të arkëtueshmet nga pacientët	113,543	-	91,194	204,737
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>123,796</b>	<b>1,674</b>	<b>130,169</b>	<b>255,639</b>
<b>Detyrimet</b>				
Të pagueshme tregtare e të tjera	205,895	4,884	978,578	1,189,357
Hua	-	-	401,475	401,475
<b>Total i detyrimeve financiare</b>	<b>205,895</b>	<b>4,884</b>	<b>1,380,053</b>	<b>1,590,832</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>(82,099)</b>	<b>(3,210)</b>	<b>(1,249,884)</b>	<b>(1,335,193)</b>



# American Hospital Sha

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara

(Shumat në '000 Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

### 21. Instrumente financiar – vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

#### Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(iv) Rreziku i tregut (vazhdim)

Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)

	31 dhjetor 2016			Totali
	Lek	USD	Euro	
<b>Aktivet financiare</b>				
Mjete monetare e ekuivalente	16,988	137	10,570	27,695
Të arkëtueshmet nga pacientët	183,682	-	183,144	366,826
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>200,670</b>	<b>137</b>	<b>193,714</b>	<b>394,521</b>
<b>Detyrimet</b>				
Të pagueshme tregtare e të tjera dhe qira financiare	174,642	7,390	1,010,153	1,192,185
Hua	-	-	312,218	312,218
<b>Total i detyrimeve financiare</b>	<b>174,642</b>	<b>7,390</b>	<b>1,322,371</b>	<b>1,504,403</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>26,028</b>	<b>(7,253)</b>	<b>(1,128,657)</b>	<b>(1,109,882)</b>

Të pagueshmet në Euro më 31 dhjetor 2017, lidhen kryesisht me Filialin në Kosovë dhe me qiranë financiare për paisjet në spitalin e tretë të Grupit në Tiranë. Sic shpjegohet në shënimin 1, Drejtimi pret që Filiali në Kosovë të gjenerojë të ardhura të mjaftueshme (në Euro) për të qënë në gjendje të paguajë detyrimet e tij.

Kurset e këmbimit të zbatuara gjatë vitit janë si më poshtë:

LEK	Kursi mesatar		Kursi në datën e raportimit	
	2017	2016	2017	2016
EUR	134.15	137.37	132.95	135.23
USD	119.08	124.13	111.10	128.17

Një forcim (dobësim) i arsyeshëm i Euros dhe dollarit amerikan kundrejt lekut më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, do të kishte ndikuar në matjen e instrumenteve financiare të shprehura në monedhë të huaj dhe prekur fitimin ose humbjen nga shumat e paraqitura më poshtë.

	Fitim ose humbje	
	Forcim	Dobësim
<b>31 dhjetor 2017</b>		
EUR (10% lëvizje)	(124,988)	124,988
USD (10% lëvizje)	(321)	321
<b>31 dhjetor 2016</b>		
EUR (10% lëvizje)	(112,866)	112,866
USD (10% lëvizje)	(725)	725

# American Hospital Sha

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara

(Shumat në '000 Lek, nëse nuk është shprehur ndryshe)

### 21. Instrumente financiar – vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

#### Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(v) Rreziku i tregut (vazhdim)

##### Rreziku i normës së interesit

Rreziku kryesor për të cilën portofolet jo-tregtare janë të ekspozuara është rreziku i humbjes nga luhatjet në flukseve financiare të ardhshme ose vlerës së drejtë të instrumentit financiar për shkak të një ndryshimi në normat e interesit në treg (ndryshimi mes vlerës së tashme neto të aktiveve dhe detyrimeve). Rreziku nga norma e interesit është administruar kryesisht përmes monitorimit të ndryshimeve të normave të interesit.

Menaxhimi i rrezikut të normës të interesit kundrejt kufijve të ndryshimit të normës së interesit plotësohet nga monitorimi i ndjeshmërisë së mjeteve financiare dhe detyrimeve financiare të Grupit ndaj skenarëve të ndryshëm të normave të interesit standardë dhe jo standardë. Skenarët standardë që konsiderohen në baza të rregullta përfshijnë 100 pikë bazë rënie ose rritje paralele në të gjitha kurbat e normave të kthimit.

Një analizë e ndjeshmërisë së Grupit për një rritje ose ulje në normat e interesit të tregut (duke supozuar se nuk ka lëvizje asimetrike në kurbat e kthimit dhe një pozitë konstante të pozicionit financiar) është si më poshtë:

2017	skenari deri në 1 vit		skenari pas 1 viti	
	100 bp rritje	100 bp ulje	100 bp Rritje	100 bp ulje
Efeksi i vlerësuar fitim (humbje)	(4,015)	4,015	-	-

2016	skenari deri në 1 vit		skenari pas 1 viti	
	100 bp rritje	100 bp ulje	100 bp Rritje	100 bp ulje
Efeksi i vlerësuar fitim (humbje)	(3,985)	3,985	-	-

### 22. Kushtëzime dhe angazhime

#### Ligjore

Grupi është duke kontestuar raste të caktuara ligjore, që i referohen inspektimeve tatimore në vitet 2015-2016 ose pretendimeve të tjera që vijnë si rezultat i aktiviteteve normal të biznesit të Grupit. Bazuar në konsulencën ligjore, drejtimi beson se përveç provizionit të njohur si detyrim që është prezentuar në shënimin 13, nuk do të shkaktohet ndonjë humbje tjetër materiale në lidhje me çeshtjet ligjore të hapura me 31 dhjetor 2017.

#### Angazhimet e qirasë operative

Grupi ka hyrë në angazhime të qirasë me kohëzgjatje maksimale deri në 30 vjet. Megjithatë, shumica e marrëveshjeve të qirasë mund të anulohen me njoftim paraprak prej 180 ditësh. Angazhimet minimale të qirasë të pa anulueshme brenda një viti, më 31 dhjetor 2017 janë 27,882 mijë Lek (2016: 25,411 mijë Lek).

### 23. Palët e lidhura

Grupi nuk ka hyrë në transaksione me Balkan Alliance Healthcare B.V. i cili është aksionari i tij i vetëm, apo me shoqëri të lidhura me aksionarin e vetëm.

#### Transaksione me drejtorët

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017, shpërblimi i drejtorëve ekzekutivë prej 48,949 mijë Lek (31 dhjetor 2016: 44,814 mijë lekë) është i përfshirë në shpenzimet e personelit.

### 24. Ngjarjet pasuese

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkonin korrigjim ose të dhëna shtesë në pasqyrat financiare.